

LIRIA E MEDIAS
DHE SIGURIA E
GAZETARËVE

Shqipëri | Raport gjashtëmuor

JANAR

QERSHOR

2026

Isa MYZYRAJ

42

REAGIME
TË ANALIZUARA

31

RASTE DHE
ZHVILLIME

23

PROFESIONISTË
ME EMËR

8

GRA TË
IDENTIFIKUARA

Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë

Tiranë, Gusht 2026

www.agsh.al

1 / PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përmbledhje ekzekutive

Gjatë periudhës janar–qershor 2026, monitorimi i AGSH-së përshkruan një mjedis mediatik ku cenimet e lirisë së shtypit nuk janë episodike dhe nuk burojnë nga një aktor i vetëm. Gazetarët dhe punonjësit e medias u përballën me dhunë në protesta, sulme fizike, kërcënime pas investigimeve, presion verbal nga zyrtarë e politikanë, pengim në terren, përjashtim selektiv nga konferencat, kufizim të informacionit zyrtar, presion gjyqësor dhe pasiguri në punë.

Në total u analizuan 42 raste.

Gjetja kryesore

Normalizimi i gjuhës denigruese ndaj medias dhe rritja e incidenteve në terren ushqejnë njëri-tjetrin: delegjitimimi publik ul prapun e tolerancës ndaj pengimit, kërcënimit dhe dhunës ndaj gazetarëve.

Pesë prirjet kryesore

- Protestat mbetën mjediset me rrezikun më të lartë fizik për ekipet mediatike.
- Aktorë të qeverisë dhe opozitës përdorën etiketime, sulme personale ose masa selektive aksesit ndaj gazetarëve dhe mediave kritike.
- Investigimet mbi mashtrimin, korrupsionin, krimin dhe çështjet lokale sollën kërcënime të personalizuar, përndjekje ose dëmtim prone.
- Gratë gazetare u goditën shpesh përmes gjuhës që cenon njëkohësisht profesionalizmin, dinjitetin dhe identitetin gjinor.
- Kufizimet e informacionit, proceset gjyqësore, raportimet masive në platforma dhe pasiguria në punë zgjeruan presionin përtej dhunës së drejtpërdrejtë.

Info@agsh.al

Agsh.al

+355-0692303939

Rruga “Muhamet Deliu” Pall.Rear, Hyrja 3, kati 5, app 29

2 / METODOLOGJIA

Metodologjia dhe kufizimet

Raporti mbështetet në të dhënat e AGSH gjatë gjithë mujve.

Kufizimet


Ky është raport monitorimi. Të dhënat varen nga rastet që iu raportuan AGSH-së ose për të cilat ajo reagoi publikisht. Disa episode mbeten në fazën e pretendimit ose kërkojnë hetim. Për këtë arsye përdoren formulime si “sipas raportimit”, “pretendim” dhe “incident i raportuar”, ndërsa përgjegjësia juridike nuk paragjykohet.

3 / TË DHËNAT KRYESORE

Të dhënat kryesore

42	31	8	9
publikime	raste/zhvillime	raste me dhunë ose dëmtim prone	raste që prekën gra

Reagimet sipas muajit



Grafiku 1. Numri i reagimeve dhe qëndrimeve të AGSH-së. Maji kishte intensitetin më të lartë (11).

Info@agsh.al

Agsh.al

+355-0692303939

Rruga “Muhamet Deliu” Pall.Rear, Hyrja 3, kati 5, app 29

Rritja në maj lidhet me një ndërthurje incidentesh në protesta, presioni politik, kufizime të komunikimit policor, një çështje me elemente SLAPP dhe sulme të personalizuar ndaj gazetarëve. Qershori vijoi me tensione të forta rreth protestave qytetare, ndërhyrjeve në raportime live dhe sulmeve publike ndaj përfaqësuesve të medias.

Info@agsh.al


Agsh.al

+355-0692303939


Rruga “Muhamet Deliu” Pall.Rear, Hyrja 3, kati 5, app 29

3 / TË DHËNAT KRYESORE

Format kryesore të presionit



Grafiku 2. Kodim sipas formës dominuese të 31 njësive të monitorimit. Kategoritë nuk masin domosdoshmërisht rëndësinë juridike të rastit.



Grafiku 3. Aktori kryesor i lidhur me presionin, sipas përshkrimit në reagimet e AGSH-së. “Individë/protestues” përfshin persona privatë dhe pjesëmarrës në tubime.

Info@agsh.al

Agsh.al

+355-0692303939

Rruga “Muhamet Deliu” Pall.Rear, Hyrja 3, kati 5, app 29

4 / SIGURIA FIZIKE

Dhuna, kërcënimet dhe siguria fizike

Tetë njësi monitorimi u klasifikuan me formë dominuese dhunën fizike, rrezikimin e drejtpërdrejtë ose dëmtimin e pronës. Ky grup përfshin ekspozimin kolektiv të ekipeve ndaj gazit lotsjellës dhe ujit me presion më 24 janar; sulmin fizik ndaj Gentian Këllçiut; përfshirjen nga flakët të kameramanit Aldo Kashari; përndjekjen dhe dëmtimin e ambienteve të Jonida Mukjës; djegien e automjetit të Sami Currit; goditjen e ekipit të Syri TV më 9 maj; dhunën e raportuar ndaj Ervin Dushit dhe incidentin e raportuar me Osman Stafën më 22 qershor.

Protestat: zona me ekspozim të përsëritur

Në të paktën katër momente të veçanta, korpusi dokumenton rrezik, pengim ose agresion ndaj ekipeve gjatë protestave: 24 janar, 10 shkurt, 9 maj dhe cikli i protestave të qershorit. Rreziku erdhi si nga mjetet e përdorura nga policia, ashtu edhe nga protestues ose persona që ndërhyjnë në raportim.

Info@agsh.al

Agsh.al

+355-0692303939

Rruga “Muhamet Deliu” Pall.Rear, Hyrja 3, kati 5, app 29

Reagimet e AGSH-së tregojnë një vazhdimësi: etiketimi publik i gazetarit si i pabesueshëm ose i “porositur” pasohet nga ekspozim ndaj turmës, kërcënime të personalizuar dhe, në disa raste, dhunë ose dëmtim prone. Jo çdo sulm verbal çon në dhunë, por përsëritja e gjuhës delegjitimuese krijon një mjedis ku agresioni ndaj gazetarit perceptohet më lehtë si i pranueshëm.

Problemet e reagimit institucional

- Në shumë raste AGSH kërkoi hetim të shpejtë, të plotë dhe transparent, çka tregon mungesë informacioni publik mbi ecurinë e çështjeve.
- Në protesta, identifikimi i dukshëm i gazetarëve nuk shmangu goditjen nga uji me presion, gazi ose ndërhyrjet e protestuesve.
- Redaksitë nuk rezultojnë gjithmonë të pajisura në mënyrë të standardizuar me maska, syze, helmeta dhe protokolle evakuimi.
- Dëmtimi i pajisjeve dhe automjeteve nuk është vetëm humbje materiale: ai ndërpret raportimin dhe krijon efekt frikësues për redaksinë.

Info@agsh.al

Agsh.al

+355-0692303939

Rruga “Muhamet Deliu” Pall.Rear, Hyrja 3, kati 5, app 29

5 / PRESIONI POLITIK DHE AKSESI

Presioni politik dhe aksesimi në informacion

Aktorët politikë dhe zyrtarët publikë përbëjnë kategorinë më të shpeshtë të aktorit kryesor në kodimin e raportit. Shembujt përfshijnë gjuhën përçmuese ndaj Blendi Fevziut dhe Klodiana Lalës; përjashtimin e Ambrozia Metës dhe Isa Myzyrajt nga konferenca nga ana e Kryeministrit Edi Rama; etiketimet e përgjithshme ndaj mediave nga Kreu i PD-së Sali Berisha; sulmet ndaj Lindita Çelës nga Monika Kryemadhi; si dhe deformimin e deklaratës së Kristina Vokos dhe sulmin ndaj BIRN Albania nga deputeti

Komunikimi i Policisë dhe vakuumi informativ

Në maj, AGSH reagoi dy herë për strategjinë e re të komunikimit të Policisë së Shtetit. Shqetësimi kryesor ishte centralizimi i tepruar dhe vonesa e informacionit për ngjarje të rënda. Kur kanalet zyrtare kufizohen në operacione dhe aktivitete protokollare, krijohet vakum që vështirëson verifikimin, favorizon spekulimin dhe rrit varësinë nga burimet joformale.

Info@agsh.al

Agsh.al

+355-0692303939

Rruga “Muhamet Deliu” Pall.Rear, Hyrja 3, kati 5, app 29

6 / PRESIONI LIGJOR, DIGJITAL DHE EKONOMIK

Presioni ligjor, digjital dhe ekonomik

Masa paraprake dhe efekt frikësues

Në çështjen që lidhej me biznesmenin Dionis Teqja, AGSH ngriti shqetësim për heqjen ose bllokimin e publikimeve para përfundimit të shqyrtimit dhe për kërkesa dëmshpërblimi që arrinin deri në 500 mijë euro ndaj gazetarit Arsen Rusta. Edhe kur procesi gjyqësor është formalisht i ligjshëm, masa joproporcionale mund të prodhojë efekt frikësues dhe vetëcensurë.

Censura përmes platformave

Dy raste CNA dhe Lol Albania tregojnë dobësinë e mediave e faqeve kritike ndaj raportimeve masive ose mekanizmave automatike të platformave. Këto mjete mund të keqpërdoren për të pezulluar përmbajtjen pa një shqyrtim proporcional dhe transparent.

Punësimi dhe autonomia editoriale

Largimi i Ilir Babaramos nga Report TV dhe largimet e shumta në A2 CNN sollën në vëmendje pasigurinë e marrëdhënieve të punës, transparencën e procedurave dhe mundësinë që vendimet e punësimit të ndikojnë mbi pluralizmin e mendimit. Raporti nuk përcakton motivin juridik të këtyre vendimeve, por evidenton nevojën për procedura të dokumentuara, kontrata të rregullta dhe mekanizma ankimi.

RTSH dhe pavarësia e medias publike

Debati për mbylljen, privatizimin ose financimin e RTSH-së u trajtua nga AGSH si çështje e lirisë së medias, jo vetëm si çështje menaxheriale. Reformimi i transmetuesit publik duhet të ndjekë mekanizma ligjorë, të ketë financim të qëndrueshëm dhe të mbrojë autonominë editoriale nga presioni politik.

Info@agsh.al

Agsh.al

+355-0692303939

Rruga “Muhamet Deliu” Pall.Rear, Hyrja 3, kati 5, app 29

7 / GRATË DHE VAJZAT GAZETARE

Gratë dhe vajzat gazetare

Nëntë raste me dimension gjinor

Tetë gra gazetare ose drejtuese mediatike u identifikuan me emër në raste individuale. Një reagim tjetër dënoi sulmin seksist ndaj një grupi kolegesh. Në total, çështjet që prekën gra përbënin 29% të rasteve.

Sulmet ndaj grave nuk ishin të kufizuara në një formë. Ato përfshinë rrezik fizik, përndjekje, kërcënime me simbolikë vdekjeje, përjashtim nga aksesit, diskreditim politik dhe gjuhë seksiste ose poshtëruese online. Karakteristikë e përsëritur ishte kalimi nga kritika e punës te sulmi mbi dinjitetin, reputacionin dhe identitetin personal të gazetares.

Gazetarja	Data	Forma	Përshkrimi i shkurtër
Klodiana Lala	14 janar	Sulm verbal institucional	Replikë publike me gjuhë përçmuese nga Kryeministri, në kuadër të kritikave për përmbajtjet.
Jonida Mukja	12 shkurt	Përndjekje dhe dëmtim	Përndjekje pas një investigimi dhe dëmtim i ambienteve të punës.
Ambrozia Meta	13 mars	Përjashtim nga aksesit	Përjashtim i përhershëm i deklaruar nga konferencat për shtyp të Kryeministrit.
Avi Mema	3 prill	Kërcënim i rëndë online	Imazh i manipuluar ku paraqitej në arkivol, i shoqëruar me mesazhe kërcënuese.
Marsi Cerma	9 maj	Rrezik fizik në protestë	U godit në fytyrë nga uji me presion dhe u ndje keq gjatë raportimit.
Lindita Çela	13 maj	Diskreditim politik	Aludime të pambështetura që vunë në dyshim integritetin profesional.
Bleona Sari	15 maj	Gjuhë denigruese online	Insinuata personale dhe etiketime degraduese në rrjetet sociale.
Kristina Voko	10 qershor	Etiketim dhe linçim publik	Deformim i deklaratës dhe sulm ndaj saj dhe BIRN Albania nga një deputet.

Info@agsh.al

Agsh.al

+355-0692303939

Rruga “Muhamet Deliu” Pall.Rear, Hyrja 3, kati 5, app 29

7 / ANALIZA GJINORE

Pse dimensionimi gjinor kërkon përgjigje të veçantë

Sulmi gjinor synon ta zhvendosë debatin nga përmbajtja e raportimit të trupi, morali, jeta private ose “vlera” personale e gazetares. Kjo rrit koston psikologjike dhe profesionale, nxit turmat online dhe mund të sjellë tërheqje nga tema të ndjeshme, veçanërisht korrupsioni, krimi dhe politika.

Modelet e evidentuara

- Seksualizim dhe insinuata: përdorim i nënkuptimeve poshtëruese për të zbehur autoritetin profesional.
- Diskreditim i koordinuar: etiketime që ftojnë audiencën të sulmojë ose përqeshë gazetaren.
- Kërcënim i personalizuar: imazhe mortore, përndjekje ose dëmtim i hapësirës së punës.
- Ndëshkim për pyetje kritike: përjashtim nga konferencat ose aludime politike ndaj integritetit.
- Rrezik fizik në terren: mungesë mbrojtjeje të posaçme gjatë protestave dhe përdorimit të mjeteve shpërndarëse.

8 / ZHVILLIME POZITIVE

Zhvillime pozitive dhe boshllëqe institucionale

Vendimi për TikTok

Më 11 mars 2026, AGSH mirëpriti vendimin e Gjykatës Kushtetuese që pranoi pjesërisht kërkesën e saj dhe të BIRN Albania dhe konstatoi se zbatimi i bllokimit të TikTok kishte cenuar lirinë e shprehjes dhe të shtypit dhe nuk përmbushte kriterin e proporcionalitetit. Ky ishte zhvillimi institucional pozitiv më i rëndësishëm i gjashtëmujorit.

Solidariteti profesional

Bojkoti i operatorëve televizivë pas plagosjes së Aldo Kasharit dhe vizita e përbashkët e organizatave e partnerëve në Bulqizë pas djegies së automjetit të Sami Currit treguan se reagimi kolektiv mund të rrisë dukshmërinë e rasteve dhe presionin për hetim.

Sinjalet nga RSF

Në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit 2026, Shqipëria renditet e 83-ta nga 180 vende, me 56.52 pikë, tre vende më poshtë se në vitin 2025. Treguesi politik renditet i 121-ti dhe ai

Info@agsh.al

Agsh.al

+355-0692303939

Rruga “Muhamet Deliu” Pall.Rear, Hyrja 3, kati 5, app 29

ekonomik i 137-ti. RSF vëren konfliktet e interesit biznes-politikë, përqendrimin e pronësisë, shpërndarjen jotransparente të financimit shtetëror, sulmet diskredituese dhe ngacmimin online ndaj grave gazetare.

9 / PËRFUNDIME

Përfundime dhe rekomandime

Gjashtëmujori i parë i vitit 2026 tregon se liria e medias në Shqipëri cenohet nga një kombinim faktorësh: polarizimi politik, toleranca ndaj gjuhës denigruese, rreziku në terren, dobësia e mekanizmave të aksesit, presioni ligjor dhe digjital, si dhe pasiguria ekonomike e gazetarëve. Këto forma nuk duhen trajtuar si probleme të ndara; ato krijojnë së bashku një klimë që nxit vetëcensurën dhe dobëson rolin mbikëqyrës të medias.

Për institucionet shtetërore

- Të publikojnë statusin dhe rezultatin e hetimeve për çdo sulm, kërcënim ose dëmtim prone ndaj punonjësve të medias.
- Të zbatojnë protokolle policore për identifikimin dhe mbrojtjen e gazetarëve në protesta, me hetim të pavarur kur policia pretendohet si autore.
- Të garantojnë akses të barabartë në konferenca dhe informacion, pa lista selektive ose përjashtime ndëshkuese.
- Të shmangin regjistrimin shtetëror të profesionit të gazetarit dhe të mbështesin vetërregullimin e pavarur.

Për partitë dhe aktorët publikë

- Të ndalojnë etiketimet kolektive që e paraqesin median si armike ose kriminale.
- Të kundërshtojnë raportimet me fakte dhe mekanizma ligjorë, jo me sulme personale, turma online ose kufizim aksesit.

Info@agsh.al

Agsh.al

+355-0692303939

Rruga “Muhamet Deliu” Pall.Rear, Hyrja 3, kati 5, app 29

SHTOJCA / KRONOLOGJIA**Kronologjia e rasteve dhe zhvillimeve**

Tabela përmbledh rastet dhe zhvillimet. Paralajmërimet parandaluese dhe reagimet ndjekëse nuk janë listuar si incidente të veçanta.

Data	Rasti / subjekti	Përmbledhje	Kategoria
9 janar	CNA	Tentativë për mbyllje përmes raportimeve për të drejtën e autorit.	Digjital
14 janar	B. Fevziu / K. Lala	Gjuhë përçmuese në reagim institucional.	Verbal
16 janar	RTSH	Retorikë për mbyllje, privatizim ose ndërprerje financimi.	Strukturor
23 janar	Gazetaria si profesion	Propozim publik për regjistrim/rregullim shtetëror.	Ligjor
24 janar	Ekipe mediatike	Ekspozim ndaj gazit lotsjellës dhe ujit me presion.	Siguri
30 janar	Aldo Mustafa	Pengim dhe presion i pretenduar nga policia gjatë filmimit.	Pengim
4 shkurt	Gentian Këllçiu	Sulm verbal dhe fizik gjatë raportimit në Vlorë.	Fizik
9 shkurt	RTSH	Thirrje e përbashkët për reformë të ligjshme dhe financim të mbrojtur.	Strukturor
shkurt	Grup	Ftesa selektive dhe përjashtim i shumicës së mediave.	Akses
10 shkurt	Aldo Kashari	U përfshi nga flakët pas hedhjes së lëndës djegëse mbi mjetin e Neës24.	Fizik
12 shkurt	Jonida Mukja	Përndjekje dhe dëmtim i ambienteve pas investigimit.	Kërcënim
26 shkurt	Gazetare gra	Gjuhë seksiste dhe nxitje e linçimit publik nga një koleg.	Gjinor
9 mars	Osman Stafa	Etiketim publik dhe delegjitimim pas një pyetjeje në konferencë.	Verbal

Info@agsh.al

Agsh.al

+355-0692303939

Rruga “Muhamet Deliu” Pall.Rear, Hyrja 3, kati 5, app 29

Data	Rasti / subjekti	Përmbledhje	Kategoria
11 mars	TikTok	Gjykata Kushtetuese konstatoi cenim të lirisë së shprehjes dhe shtypit.	Pozitiv
13 mars	Ambrozia Meta / Isa Myzyraj	Përrjashtim nga konferenca dhe sulm verbal.	Akses
23 mars	Ilir Babaramo	Largim nga puna; pretendime të kundërta për motivin.	Punë
30 mars	Endri Meksi / MCN TV	Pretendime publike për kërcënime; kërkesë për hetim.	Kërcënim
3 prill	Avi Mema / Nertil Mataj	Imazhe në arkivol dhe mesazhe kërcënuese pas investigimit.	Kërcënim
13 prill	Lol Albania	Mbyllje pas raportimeve masive të koordinuara.	Digjital
prill	Sami Curri	Djegje e automjetit; gazetari e konsideroi mesazh kërcënues.	Pronë
2 maj	Media në tërësi	Etiketime denigruese nga kreu i opozitës.	Verbal
6 maj	Grup / media	Masë paraprake dhe kërkesë dëmshpërblimi deri në 500 mijë euro.	Ligjor
8–16 maj	Media	Centralizim dhe vonesa në komunikimin e Policisë.	Akses
9 maj	Armando Varfi / Marsi Cerma	Goditje e ekipit të Syri TV nga uji me presion.	Fizik
13 maj	Lindita Çela	Aludime politike ndaj integritetit profesional.	Verbal
15 maj	Bleona Sari	Gjuhë fyese dhe denigruese në rrjetet sociale.	Gjinor
19 maj	Fatjon Gjinaj	Fyerje dhe kërcënim nga ish-funksionar publik.	Kërcënim
19 maj	Ervin Dushi	Dhunë fizike e raportuar në Shkodër.	Fizik
2 qershor	A2 CNN	Largime të shumta dhe shqetësime për të drejtat e punës.	Punë
5–22 qershor	Ekipe në protesta	Fyerje, intimidim, tentativa pengimi dhe sulmesh fizike.	Kolektiv

Info@agsh.al

Agsh.al

+355-0692303939

Rruga “Muhamet Deliu” Pall.Rear, Hyrja 3, kati 5, app 29

Data	Rasti / subjekti	Përmbledhje	Kategoria
10 qershor	Kristina Voko / BIRN	Deformim deklarate dhe etiketime nga deputet.	Verbal
22 qershor	Osman Stafa	Incident i raportuar; AGSH kërkoi hetim të plotë.	Siguri
26 qershor	Euroneës Albania	Ndërhyrje e synuar gjatë raportimit live.	Pengim

Info@agsh.al

Agsh.al

+355-0692303939

Rruga “Muhamet Deliu” Pall.Rear, Hyrja 3, kati 5, app 29

Info@agsh.al

Agsh.al

+355-0692303939

Rruga “Muhamet Deliu” Pall.Rear, Hyrja 3, kati 5, app 29